



REPUBLIKAE KOSOVËS / REPUBLIKAKOSOVA

Ae.nr.269/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve ["A..."], me seli në Zurich, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit ["L..."]-[B.N], avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["S..."], me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [B.R] nga Prishtina, për shkak të regresit, në shumën e përgjithshme prej 8,288.85€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.203/2015, të datës 23.04.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.09.2020 mori këtë:

AKT GJYKIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e paditësit Kompania e Sigurimeve ["A..."], me seli në Zurich dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve ["S..."], me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.203/2015, të datës 23.04.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në piken I të dispozitivit të aktgjykimit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve ["A..."], me seli në Zurich, e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["S..."], me seli në Prishtinë ashtu që në piken II të dispozitivit është detyruar Kompania e Sigurimeve ["S..."], me seli në Prishtinë, që në emër të regresit nga baza e sigurimit kasko paditësit t'ia kompensojë shumën në lartësi prej 8,288.85€, të gjitha me kamate ndëshkuese prej 8% në vite, duke filluar nga data 23.04.2019 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjore, ndërsa në piken III të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit në shumën prej 438,86€, dhe në pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1,621.46€.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve ["S..."], me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e shkallës së parë ta prishë dhe çështjen ta kthej në rigjykim për vendosje meritore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë edhe pala paditëse për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoje ankesën e paditësit, të ndryshohet aktgjykimi V.EK.nr.203/2015 i datës 23.04.2019 ne pjesën e cila i referohet borxhit dytësore/kamatëvonesës dhe shpenzimeve të kontestit ashtu qe e paditura detyrohet te paguaj kamatëvonesën prej 12% ne vit duke filluar nga data 22.08.2014 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e kontestit ne shumën prej 2,067.46€, ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat eKompania e lëndes rezulton se Kompania e Sigurimeve ["A..."], me seli në Zurich, datën 18.05.2015 ka paraqitur padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve ["S..."], me bazë kontesti rimbursim borxhi, nga baza e sigurimit kasko të paguara në emër të kompesimit të dëmit nga sigurimi. Paditësi në padi ka theksuar se me datën 27.07.2014 në fshatin ..., Komuna e Gjilanit ka ndodhur aksident i komunikacionit në të cilin janë përfshirë dy automjete, automjeti i tipit "Volkswagen" me [targa të regjistrimit ...] dhe automjeti i tipit "Land Rover", me [targa të regjistrimit ...], ne aksidentin dëme materiale në veturën e tij kishte pësuar [V.R]. Ka theksuar se duke ju referuar raportit të aksidentit dhe procesverbalit të shikimit të vendit të ngjarjes rezulton se shkaktar i aksidentit ka qenë drejtuesi i automjetit "Volkswagen" i pajisur me sigurim të detyrueshëm nga auto përgjegjësia nga e paditura. po ashtu ka shtuar se nga baza e sigurimit kasko e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj të siguruarës [V.R] duke kryer pagesa në dobi të siguruarit të saj dhe atë në emër të demit material për veturën e dëmtuar në këtë aksident në shumën prej 18,800.00CHF. Meqenëse i ka kryer pagesat ndaj të siguruarit të sajë dhe përgjegjës për aksident është e paditura, ka pretenduar se janë plotësuar kushtet ligjore për subrogim. Paditësi pas nxjerrjes se ekspertizës se makinerisë të punuar nga z. [N.SH] ka bërë precizimin e kërkesëpadsisë në shumën prej 8,727.71€.

Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka konstatuar se e paditura, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadsisë dhe ka pranuar përgjegjësinë lidhur me shkaktimin e demit por kontestuese sipas pretendimeve të autorizuarit të paditurës kontestuese në mes palëve në procedurë ka qenë lartësia e demit. Për të vërtetuar lartësinë e demit gjykata e shkallës së parë është bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertizës së ekspertit të makinerisë z.[N.SH], ku ka vërtetuar faktin se automjeti "Land Rover" me [targa të regjistrimit ...] ka

pësuar dëm të në automjet në shumën prej 8,727.71€ nga e cila shumë zbritet franshiza prej 438,86€.

Gjykata e shkallës së parë bazuar në gjendjen faktike të konstatuar dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 960 par.1, nenit 281 par.1 të LMD-së, si dhe në nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, ka vlerësuar se me pagimin e kompensimit të dëmit nga paditësja, të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësja dhe e paditura ka pasur obligim t'ia rimbursojë paditëses shumën e paguar në emër të kompensimit të dëmit andaj ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 960 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se *“me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalon në siguresin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmi”*. Ndërsa në nenin 281 të LMD-së është përcaktua se *“kur detyrim e përmbush personi, i cili ka ndonjë interes juridike në këtë çështje, atëherë i kalon atij, në bazë të vete ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha kërkesat aksesore”*, ndërsa në nenin 3 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia është përcaktuar se *“siguruesi është përgjegjës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara personave të trete, nga përdorimi i automjetit të siguar mbi bazën e auto përgjegjësisë”*. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 27.07.2014, ka qenë automjeti i tipit “Volkswagen” me [targa të regjistrimit ...], andaj konform Nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, është krijuar detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit, Paditësi ia ka paguar të siguruarit të tij kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësi.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore ankimore lidhur me lartësinë e dëmit, por gjeti se të njëjta janë të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë me të drejtë vendimin e vete lidhur me lartësinë e ka mbështetur në mendimi dhe konstatimi i ekspertit të makinerisë z. [N.SH], nga raporti i të cilit rezulton se shumën në emër të riparimit të automjetit është përcaktuar duke pasur parasysh pjesët e dëmtuara të automjetit, dhe krahasimin e tyre me procesverbalin e dëmit. Po ashtu me rastin e vlerësimit të dëmeve të automjetit është marrë për bazë edhe orët e punës për riparim, prandaj ka vlerësuar se dëmi në automjetin e paditësit është në shumën prej 8,727.71€.

Gjykata i vlerësoi pretendimet tjera ankimore të paditurit, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e të paditurit janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Kjo gjykatë e vlerëson si të pabazuar edhe pretendimin ankimor të paditësit lidhur me llogaritjen e kamatëvonesës, sepse në rastin konkret zbatohet dispozita e Nenit 940 par.2 të LMD-së me të cilin theksohet se: *“në qoftë se për çaktivimin e ekzistimit të detyrimit të siguruesit ose të shumës së tij nevojitet një kohë, ky afat fillon të rrjedhë nga dita kur është vërtetuar ekzistimi i detyrimit të tij dhe shuma e tij”*. Prandaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vendosur që kamatëvonesa të paguhet nga data kur është përcaktuar shuma e detyrimit respektivisht nga data e precizimit të kërkesëpadisë.

Kamata e kërkuar nga paditësi prej 12, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.

Paragrafi 7, i nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Nga kjo rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 lidhur me Nenin 940 të LMD-së, por jo edhe kamatë “të kualifikuar” sipas dispozitave Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.269/2019, dt. 16.09.2020

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.v.

